

FEUILLET D'INFORMATION AUX MIGRANTS (traduction albanaise)

FLETË INFORMIMI PËR EMIGRANTËT

Historia juaj na intereson !

Nëse i lexoni këta rrjeshta, do të thotë se ne kemi mësuar prej një personi të afërt të rrethit tuaj që ju keni përjetuar apo po kaloni një periudhë të vështirë, të shkakuar nga ligji zviceran apo të zbatimit të ligjit nga ana e autoriteteve.

Historia juaj na intereson dhe do të donim ta shfrytëzonim në luftën tonë për ligje më të mira dhe më të favorshme për të huajt që jetojnë në Zvicër, cilido qoftë rezultati i kërkesës së azilit apo i qëndrimit të quajtu « ilegal ».

Misioni i Observatorit (Vëzhguesit)

Vëzhguesi i të drejtës së azilit dhe i të huajve ka për mision të vërë në pah realitetin e jetës së personave të migruar në Zvicër. Ne i paraqesim popullatës Zvicerane raste ku zbatimi i ligjit në fuqi sjell padrejtësi dhe pasoja të rënda në planin njerëzor.

Ne jemi të bindur se njerëzit, sa më shumë të jenë të informuar mbi problemet që autoritetet u shkaktojnë të huajve aq më shumë do të ecin përpara mentalitetet dhe do të përmirësohen ligjet. Ju me siguri e dini që disa aktorë politikë përhapin gënjeshtër lidhur me të huajt me qëllim që t'i fusin frikën popullit dhe të mbledhin votat e zgjedhësve të frikësuar. Janë pikërisht këto gënjeshtër që ne duam t'i luftojmë.

Për këtë qëllim ne kemi nevojë për dëshminë tuaj konkrete. Mbi dëshminë tuaj ne do të ndërmarim veprime politike, mediatike si dhe aksione të sensibilizimit të popullatës zvicerane.

Parlajmërim

Ne dëshirojmë të ju përkujtojmë që qëllimi ynë nuk është **të mbrojmë rastin tuaj individual**, por ta marrim si shembull atë për ta përmisuar gjendjen në planin e përgjithshëm. Ne nuk do të ndërhyjmë në procedurën tuaj juridike në shqyrtim. Në bëjmë vetëm një punë komunikative.

Në ju parlajmërojmë se rasti juaj do të përdoret për të treguar realitetin e emigrantëve. Kjo do të thotë që kur ju vendosni që ne ta përdorim rastin tuaj ai mund të përmend në ndonjë debat publik (artikull gazete, të përmendet si argument nga njerëzit politikë, në raportet e organizatave).

Emri juaj nuk do të përmendet (ne përdorim emra jo të vertetë), por ta jeni të vetëdijshëm që përshkrimet janë të hollësishme dhe rasti juaj mund të njihet nga autoritetet. Mëgjithatë ne kemi vëzhguar se publikimi i një rasti nuk i ka prishur punë ose nxjerrë telashe asnjë personi. Ju keni të drejtë ta shikoni edhe njëherë rastin tuaj në dokumentet tona përpara se ai të publikohet dhe ne mund t'i ndryshojme disa detaje nëse ju mendoni se ato cenojne sferën tuaj private.

Si duhet vepruar ?

Me qëllim që ne mund ta përshkruajme rastin tuaj, është e domosdoshme që ne të kemi disa dokumente kryesore të dosjes suaj :

- **Vendimet e autoriteteve** (policisë të të huajve të kantonit ku banoni, Zyrës së Emigrimit, Gjykatës Kantonale ose Gjykatës Federale)
- **Ankesat** që i keni bërë kundër këtyre vendimeve
- **Dokumente tjera** që ju i vlersoni si të nevojshme për ta kuptuar rastin tuaj : letra të autoriteteve, raporte të intervistave në policinë e të huajve, procesverbale të intervistave (procedurës së azilit etj).

Mos ngurroni të kërkonin ndihmën e një personi të besueshëm (p.sh. mandatarit ose personit zyrtar që ju përfaqëson) për t'i kopjuar këto dokumente. Këto dokumente do të ruhen me shumë kujdes në lokalet tona dhe vetëm bashkpunëtorët e « Observatorit » (Vëzhguesit) mundën t'i konsultojnë.

Kopjet e këtyre dokumentave ju mund t'i dërgoni në adresën e mëposhtme :

Observatoire romand du droit d'asile et des étrangers (ODAE)
Case Postale 270
1211 Genève 8

Ju mund të na kontaktoni në çdo kohë gjatë permancës së « Observatorit » për të mësuar se çfarë ka ndodhur me historinë tuaj : Mariana Duarte, 022 310 57 30, ose info@odae-romand.ch

Duke shpresuar se e keni kuptuar rëndësinë e këtij veprimi, ju falendëroj paraprakisht për bashkpunimin tuaj të ardhshëm duke ju shprehur mirëkuptimin tim të plotë për momentet e vështira që po i kaloni.

Mariana Duarte
Observator i të drejtës së azilit dhe të huajve